




REPUBLIKA E SHQIPËRISË



KËSHILLI I QARKUT SHKODËR

Nr. 225/1 Prot.

Shkodër me 3103 2026

V E N D I M

Nr. 08, datë 27.03.2026

PËR

PROPOZIMIN PËR DHËNIEN E STATUSIT “DËSHMOR I ATDHEUT”

Këshilli i Qarkut Shkodër, i mbledhur sot me datë 27.03.2026, pasi mori në shqyrtim kërkesën e Shoqatës Atdhetare “Dukagjini”, organizatës së veteranëve të L.A.N.C-it “*Propozim për dhënie të statusit Dëshmor i Atdheut*”, në mbështetje të Ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, si dhe Ligjit Nr. 109/2018 “*Për statusin e dëshmorit të atdheut*”, neni 5 dhe 11, me qëllim nderimin dhe përjetësimin e kujtimit të atyre që kanë dhënë jetën për lirinë, pavarësinë dhe mbrojtjen e territorit të Republikës së Shqipërisë, si dhe për përpjekjet për çështje kombëtare para dhe pas shpalljes së Pavarësisë,

pasi u kalua në proces votimi të fshehtë nga anëtarët e Këshillit të Qarkut, **ku u miratua me: 15 vota Pro, 0 vota Kundër dhe 0 vota Absenim;**

VENDOSI:

1. T’i propozojë, Komisionit për dhënie të statusit “Dëshmor i Atdheut” pranë Ministrisë së Mbrojtjes, për 164 luftëtarët e rënë, sipas listës në Shtojcën 1, pjesë integrale e këtij vendimi.
2. Ngarkohet Administrata e Këshillit të Qarkut Shkodër për zbatimin e këtij vendimi dhe për përcjelljen e dokumentacionit përkatës pranë institucioneve përgjegjëse.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe zbatohet sipas përcaktimeve të pikës 3 të nenit 78 të Ligjit Nr. 139/2015.





SHTOJCË 1 - Pjesë integrale e Vendimit nr. 08, datë 27.03.2026

LISTA E LUFTËTARËVE TË PROPOZUAR

Për dhënie të Statusit “Dëshmor i Atdheut”

I. Luftëtarë, rënë kundër pushtuesit Osman

(37 persona)

1. Marash Tuci
2. Ndre Pepa
3. Vat Nika
4. Çun Luci
5. Ndre Koltona
6. Deli Pjetra
7. Hasan Pepa
8. Marash Pali
9. Zek Jakini
10. Kole Gjoni
11. Marash Kola
12. Deli Ndou
13. Ndre Hosa
14. Pal Gjoka
15. Preke Ndou
16. Lulash Bala
17. Gjon Ndoka
18. Nike Lulashi
19. Gjon Pali
20. Mirash Prela
21. Shytan Nika
22. Ndue Mhilli
23. Mirash Ndou
24. Ndue Marash Nikolla
25. Nike Luci
26. Preke Gjoni
27. Marash Kola
28. Leke Ndou
29. Gjelo Uka
30. Xhur (Gjon) Kola
31. Marash Uka
32. Gjelo Kiri
33. Bush Delija
34. Ndre Buxha
35. Gjelo Nika
36. Dede Alia
37. Sokol Marashi

II. Luftëtarë, rënë kundër forcave malazeze serbe

(110 persona)

1. Kole Ndoja
2. Ndue Prela
3. Ndok Prela
4. Col Deda
5. Nike Gjoni
6. Vocer Preka
7. Deli Preka
8. Preke Leka
9. Nike Marku
10. Zef Preka
11. Kole Ndue Leka
12. Ndoke Marshai
13. Luce Mirashi
14. Gjon Ndoka
15. Maç Ndoka
16. Kole Luca
17. Bjeshka Dedja
18. Dede Pjetra
19. Pjeter Luli
20. Mark Prela
21. Prele Kola
22. Gjon Lula
23. Stak Narashi
24. Preke Gjeshi
25. Pal Nika
26. Preke Ndoka
27. Gjesh Ndoka
28. Marash Ndoka
29. Gjesh Ujka
30. Ndue Nika
31. Tome Preka
32. Dede Preka
33. Prenash Preka
34. Prele Doda
35. Kole Gjoni
36. Preke Leka
37. Pjeter Lota
38. Marash Pali
39. Sokol Nika
40. Marash Nika
41. Çun Marashi
42. Mrike Matia
43. Col Marashi
44. Nike Leka
45. Ndoke Shytani
46. Marash Ndreu
47. Gjon Ndreu
48. Mark Lula

- 
49. Nike Marashi
 50. Mirash Gjoni
 51. Gjelosh Kola
 52. Kole Leka
 53. Kole Pepa
 54. Gjergj Pepa
 55. Pal Ndou
 56. Gjon Ndou
 57. Gac Toma
 58. Vate Marku
 59. Kokërr Nika
 60. Martin Ndoka
 61. Pal Leka
 62. Pjeter Gjeloshi
 63. Ndue Ndreu
 64. Pashka Zefja
 65. Ndoc Prela
 66. Prele Nika
 67. Kole Pali
 68. Lul Pali
 69. Kole Dusha
 70. Zef Marku
 71. Tome Zefi
 72. Prendash Zefi
 73. Mhill Zefi
 74. Gjon Nika
 75. Ndoke Vata
 76. Mark Preka
 77. Mark Sadria
 78. Nike Çuni
 79. Ali Leka
 80. Çoban Lula
 81. Marash Ndou
 82. Lulash Sokoli
 83. Nike Mhilli
 84. Kole Mitri
 85. Preke Lulashi
 86. Sokol Lulashi
 87. Cubel Tahiri
 88. Vate Marashi
 89. Preke Mhilli
 90. Buç Vata
 91. Pjeter Lulashi
 92. Preke Staka
 93. Vate Gjeloshi
 94. Mark Vata
 95. Cel Pali
 96. Dede Gjuri (Xhuri)
 97. Hajdar Uka
 98. Deli Kola
 99. Shpend Delia
 100. Shytan Staka

- 
- 101.Ndoc Marku
 - 102.Pjeter Ndou
 - 103.Kole Nika
 - 104.Marash Ndou
 - 105.Nike Çuni
 - 106.Mark Vuksani
 - 107.Kole Shpendi
 - 108.Mark Milani
 - 109.Zef Delia
 - 110.Babun Celi

III. Luftëtarë të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare


(17 persona)

1. Martin Pali
2. Zef Delia
3. Dede Vuksani
4. Deli Sokoli
5. Pjeter Delia
6. Pal Mirashi
7. Kole Qerimi
8. Pal Kola
9. Nike Delia
10. Vate Prele Pepa
11. Pëllumb Gjoni
12. Nike Sokoli
13. Pjeter Ndou
14. Grime Ndou
15. Mhill Hajdari
16. Zef Toma
17. Zenel Ymeri

Të propozuar: 164 luftëtarë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



KËSHILLI I QARKUT SHKODËR

Nr. 22/2 Prot.

Shkodër me 31.03.2026

RELACION

PËR PROJEKT - VENDIMIN

“PËR MBËSHTETJEN E PROPOZIMIT PËR DHËNIEN E STATUSIT ‘DËSHMOR I ATDHEUT’ PËR LUFTËTARËT NGA TREVA E DUKAGJINIT”

Shoqata Atdhetare “Dukagjini” ka paraqitur pranë Këshillit të Qarkut Shkodër një kërkesë të argumentuar për dhënie të Statusit “Dëshmor i Atdheut” për 164 (njëqind e gjashtëdhjetë e katër) luftëtarë nga treva e Dukagjinit, të cilët kanë dhënë jetën në përpjekje për lirinë, pavarësinë dhe mbrojtjen e territorit të vendit në periudha të ndryshme historike duke u mbështetur në:

- Ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar;
- Ligjin nr. 109/2018 “Për Statusin e Dëshmorit të Atdheut”, neni 5 dhe neni 11;
- Dokumentacionin dhe kërkesën e paraqitur nga Shoqata Atdhetare “Dukagjini”, protokolluar pranë Këshillit të Qarkut Shkodër me nr. 1561 prot., datë 30.01.2026, me objekt: “Propozim për dhënie të statusit ‘Dëshmor i Atdheut’ për luftëtarët dukagjinas”, si dhe shkresën e Organizatës së veteranëve të LANÇ-it.

Sipas dokumentacionit të paraqitur, këta luftëtarë kanë rënë në përballje me pushtues të ndryshëm dhe kanë kontribuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në çështjen kombëtare dhe në konsolidimin e shtetit shqiptar.

Konkretisht, sipas materialeve të depozituara rezultojnë:

- **37 (tridhjetë e shtatë) luftëtarë** kanë rënë në luftë kundër pushtuesit osmano-turk, duke kontribuar në përpjekjet për lirinë dhe pavarësinë e vendit dhe në proceset historike që çuan në shpalljen e Pavarësisë së Shqipërisë më 28 nëntor 1912;
- **110 (njëqind e dhjetë) luftëtarë** kanë rënë në përballje me forcat ushtarake malazeze dhe serbe, veçanërisht gjatë kryengritjeve kombëtare të viteve 1911–1912 dhe përpjekjeve për mbrojtjen e trojeve shqiptare;
- **17 (shtatëmbëdhjetë) luftëtarë** kanë rënë gjatë Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, në përballje me pushtuesit nazi-fashistë, duke kontribuar në çlirimin e vendit dhe rivendosjen e lirisë kombëtare.

Dokumentacioni i paraqitur nga Shoqata Atdhetare “Dukagjini” është shoqëruar për secilin rast me referenca dhe burime dokumentare nga botime, studime dhe materiale historike të publikuara në fushën e kërkimit historik, të cilat evidentojnë figurën, veprimtarinë dhe kontributin e personave të propozuar në përpjekjet për liri dhe pavarësi kombëtare.

Nga shqyrtimi i materialeve të paraqitura rezulton se këta luftëtarë kanë dhënë jetën në mbrojtje të çështjes kombëtare dhe të integritetit territorial të vendit, duke kontribuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në proceset historike që çuan në shpalljen dhe konsolidimin e shtetit shqiptar.

Në referim të Ligjit nr. 109/2018 “Për Statusin e Dëshmorit të Atdheut”, veçanërisht nenit 5, statusi “Dëshmor i Atdheut” u jepet personave që kanë humbur jetën për lirinë, pavarësinë kombëtare dhe mbrojtjen e territorit të Republikës së Shqipërisë, si dhe për çështje të rëndësishme kombëtare para dhe pas shpalljes së Pavarësisë.

Në dokumentacion përfshihet, mbështetja e Organizatës së veteranëve të LANÇ-it nr. 105, datë 29.01.2026 dhe një shkresë e Bashkisë Shkodër, nr. 2062, datë 30.01.2026, çertifikatë negative për regjistrat themeltarë për fshatrat e Dukagjinit para vitit 1945.

Në këto kushte, bazuar në dokumentacionin e paraqitur dhe në referencat historike përkatëse, vlerësohet se kërkesa e paraqitur është e argumentuar dhe meriton të përcillet për shqyrtim sipas procedurave ligjore në fuqi.

Për sa më sipër, propozohet që Këshilli i Qarkut Shkodër të mbështesë propozimin e paraqitur nga Shoqata Atdhetare “Dukagjini” për dhënien e Statusit “Dëshmor i Atdheut” për 164 luftëtarë nga treva e Dukagjinit, si dhe të përcjellë dokumentacionin përkatës pranë Ministrisë së Mbrojtjes, si institucioni kompetent për verifikimin dhe vijimin e procedurave përkatëse në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Miratimi i këtij propozimi përbën një akt të rëndësishëm institucional në nderim dhe vlerësim të sakrificës së këtyre luftëtarëve për lirinë dhe pavarësinë e Atdheut.

